

TË RËNDËSISHME



- Përfitues të mundshëm fermerë individual, subjekt me status fizik, juridik dhe SHBB;
- Aplikantët duhet të kenë pronësi ose me qira tokën/objektin, për të paktën 5 vjet duke filluar nga viti i aplikimit;
- Aplikanti mund të aplikojë dhe përfitojë në më shumë se një masë mbështetëse;
- Investimi për të cilin kërkohet mbështetje nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës;
- Në rastet kur vlera e investimit të pranueshëm (pa TVSH) është mbi 5 milion lekë, aplikanti duhet të dorëzojë planin e biznesit;
- Përfituesve nga masat 9-17, pas nënshkrimit të kontratës, u jepet paraprakisht deri në 30% e financimit të miratuar, kundrejt një garancie bankare ose sigurimi. Kërkesa për këtë parapagesë duhet dorëzuar në AZHBR brenda 15 ditëve pune nga data e kontratës;
- Aplikimet kryhen pranë zyrave qendrore të AZHBR-së.

TELEFONO FALAS AZHBR

0800 83 83

agro  pika

www.azhbr.gov.al



SKEMA KOMBËTARE E INVESTIMEVE

2025

30 KORRIK - 30 SHTATOR



SERRA DIELORE



UJITJE ME PIKA



AGROPËRPUNIM



MBJELLJE TË REJA



STALLA
DHE STABILIMENTE



AGROTURIZËM



RRJETA
ANTIBRESHËR



MEKANIZIM



AKUAKULTURË



MASAT MBËSHTETËSE



Masa 9

Ndërtimi i serrave diellore të reja për perime, luleshtrydhe dhe rrush tavoline përfshirë edhe instalimin e sistemit të ujitjes, me sipërfaqe minimale **0.2 ha** dhe sipërfaqe maksimale **2 ha**. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se: **15,000 000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë/ha** për serrat e prodhimit të perimeve; **8,000 000 (tetë milion) lekë/ha** për serrat e prodhimit të rrushit për tavolinë; **4,000 000 (katër milion) lekë/ha** për serrat (tunelet plastike) të prodhimit të luleshtrydheve.

Masa 10

Mbjelljet e reja të pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe vreshtave, financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se **0,5 ha** dhe jo më shumë se **10 ha**. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se **800,000 (tetëqind mijë) lekë/ha**. Përfitojnë pagesë shtesë fermerët që instalojnë sistemet e ujitjes me pika. Masa e përfitimit të jetë në **50%** të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se **250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha**.

Masa 11

Rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese me pemë frutore, agrume dhe vreshta. Masa e përfitimit të jetë në **50%** të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se **1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/ha**. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se **1 (një) ha** dhe jo më shumë se **5 (pesë) ha**.

Masa 12

Ndërtim i sistemit të ujitjes me pika në pemëtore, ullishte, agrume dhe vreshta ekzistuese. Masa e përfitimit të jetë në **50%** të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se **250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha**. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se **1 (një) ha** dhe jo më shumë se **10 ha**.



MASAT MBËSHTETËSE



Masa 13

Ndërtimi e ambienteve të reja për mbarështimin e kafshëve dhe stabilimenteve për rritjen e shpendëve, përfshirë pajisjet/sistemet e nevojshme, me kapacitet jo më pak se **10 (dhjetë) lopë**, jo më pak se **100 (njëqind) të imta**, jo më pak se **10 (dhjetë) dosa** dhe jo më pak se **10,000 (dhjetë mijë) shpendë**. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se **15,000 000 lekë (pesëmbëdhjetë milion)** për subjekt.

Masa 14

Mbështetje për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale. Masa e përfitimit të jetë në **50%** të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se **5,000 000 (pesë milion) lekë** për subjekt.

Masa 15

Mbështetje për linja/makineri/pajisje për përpunimin, seleksionimin, paketimin dhe etiketimin e perimeve, frutave, rrushit dhe verës, ullirit dhe vajit të ullirit në **50%** të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se **7,500 000 (shtatë milion e pesëqind mijë) lekë** për subjekt.

Masa 16

Mbështetje për investime në agroturizëm me një masë përfitimi në **50%** të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë **15,000 000 lekë (pesëmbëdhjetë milion)** për subjekt.

Masa 17

Mbështetje për akuakulturën detare për koshat e rritjes së peshkut (vetëm për koshat dhe rrjetat). Masa e përfitimit të jetë në **50%** e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se **15,000 000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë** për subjekt.